

VENDIM
Nr. 134, datë 2.3.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 577, DATË 3.8.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I OBJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS ‘MUJO ULQINAKU’ (SEG. I DYTË) DHE RRUGËS ‘JAKOV MILE’, FIER”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 577, datë 3.8.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 3, shifra “4 006 581 (katër milionë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një)” zëvendësohet me shifrën “4 844 557 (katër milionë e tetëqind e dyzet e katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë)”.

b) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 4 844 557 (katër milionë e tetëqind e dyzet e katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekësh, përballohet, si më poshtë vijon:

- 4 006 581 (katër milionë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) lekë, nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë;

- 837 976 (tetëqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë, nga buxheti i Bashkisë Fier.”.

2. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i miratuar për Bashkinë Fier.

3. Tabela, që i bashkëlidhet vendimit nr. 577, datë 3.8.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Bashkia Fier dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA E SHPRONËSIMIT TË PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT: “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VKM NR. 577, DATË 3.8.2016, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI ‘RIKONSTRUKSION I RRUGËS ‘MUJO ULQINAKU’ (SEG. I DYTË) DHE RRUGËS ‘JAKOV MILE’, FIER”, TË NDRYSHUAR

Nr.	Emër/atësia/mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe e përgjithshme e truallit (m ²)	Sipërfaqe shpronësimi	Çmimi	Vlera e tokës truall (lekë)	Sip. totale e ndërtesës me certifikatë (m ²)	Sip. e prekur e ndërtesës (m ²)	Amortizimi (%)	Vlera e ndërtesës me preventiv (lekë)	Vlera totale/ lekë	Shënime
						Tokë truall (m ²)	Tokë truall /m ²							
1	Sokol Nazmi Mecaj	8533	7/996	truall+ndërtesë	177	177	11,026	1,951,602.00	48.00	48.00	30%	1,007,509	2,959,111	Konfirmuar nga ZVPP-ja
2	Kostandin Jani Boçova; Leonora Jani Shkurta; Theodhor Jani Boçova; Zhaneta Jani Mone; Virgjina Jani Petani; Sofie Jani Kule; Vasillaq Jani Boçova; Arsino Jani Boçova	8533	7/929	truall	400	51.5	11,026.00	567,839.00	-	-	-	-	567,839.00	Konfirmuar nga ASHK-ja; pezullohen veprimet, shpronësuar me VKM nr. 577, datë 3.8.2016
3	Halime Shateri e të tjerë	8533	7/257	85	85	11,026	937,210	-	-	-	-	937,210	937,210	Konfirmim nga ZVPP-ja
4	Kafaze Arif Saliq; Ilmi Nazif Saliq; Altin Nazif Saliq; Fatmir Nazif Saliq	8533	6/502	truall+ndërtesë	445	34.5	11,026.00	380,397.00	-	-	-	-	380,397.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT													4,844,557.00	

Shënime.

Vlerësimi i tokës truall është llogaritur bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”;

Vlerësimi i objektit "ndërtesë" është bërë në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar.